

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t'i bëjë presion Perëndimit
ADRESA	https://albeu.com/kosove/fetoshi-fjalimi-i-vuciqit-ne-okb-synoi-ti-beje-presion-perendim-it/1031544/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 18:24:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 18:19:39 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	df243dec06562483ad27006dc87b035b24506260d6283c1da58d84b697dc1b7c
TEKSTI	52c55b8238f1a8f03e62911179a1da236a9b8ffc0e9c583fa95dc2cf214cdc75
PAMJA	1268fe3795b87e08061997c46abd11d606547e8fdb6890a2dc36f9c8077b16d1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	cf54dcc61cce2944a760d4fc0ec35582886bafdc7bb3854f1b6c556485863c80
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	e5625a2b3a70b3c40eaff938d2f4a87fb4cf81b6cc2ef2b38db74408074a14f5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/cf54dcc61cce2944a760d4fc0ec35582886bafdc7bb3854f1b6c556485863c80>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t'i bëjë presion Perëndimit



Arben Fetoshi, drejtues i Institutit për Studime të Luftës Hibride "Octopus", thotë se fjalimi i presidentit serb Aleksandar Vuçiq në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara u ndërtua mbi disa shtylla: narrativën për Kosovën, akuzat ndaj Kroacisë dhe lavdërimet për Presidentin Trump. Sipas tij, këto elemente zbulojnë objektivat e "Botës Serbe" dhe shërbejnë për të legjitimuar agresionin e Vladimir Putinit në Ukrainë.

Në analizën e tij me titull "Recetat perfide të Serbisë në Nju Jork: Moralizimet e Vuçiqit në Asamblenë e Përgjithshme si presion ndaj Perëndimit", Fetoshi vlerëson se Vuçiqi e përdori foltoren e OKB-së për ta ushtruar presion ndaj vendeve perëndimore. Presidenti serb, sipas tij, e paraqiti Serbinë si viktimë të "padrejtësisë" së Perëndimit dhe ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 si ngjarjen që pretendohet se "shkatërroi" rendin ndërkombëtar.

Fetoshi e analizon fjalimin përtej çështjes së Kosovës, duke e vendosur atë në një kuadër më të gjerë rajonal dhe gjeopolitik. Ai argumenton se Vuçiqi u përpoq të vinte në qendër idenë e një padrejtësie të Perëndimit ndaj Serbisë, ndërsa la në hije përgjegjësitë dhe realitetin e luftërave të viteve '90.

"Na ishte njëherë një ministër finok, që i kishte ngjizur ambalazhat për terrorin e shefit të tij dhe 30 vjet më pas, në kryeqendrën e diplomacisë botërore, tentoi t'i 'gozhdojë' ata që e ndalën terrorin, spastrimin etnik dhe gjenocidin në Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë e Kosovë", shkruan Fetoshi në hyrje të analizës.

Sipas tij, presidenti serb u përpoq të lidhte në të njëjtën skemë argumentuese Kosovën e periudhës 1999–2008 me Ukrainën e sotme. Në këtë mënyrë, ndërhyrja e NATO-s dhe njohja e pavarësisë së Kosovës paraqiten si precedent që, sipas Vuçiqit, hapi "Kutinë e Pandorës". Fetoshi thekson se një qasje e tillë anashkalon represionin, masakrat, dhunimet dhe spastrimin etnik, të dokumentuara nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë dhe të lidhura me reagimin e Perëndimit.

të fundit /



Fetoshi: Fjalimi i Vuçiqit në OKB synoi t'i bëjë presion Perëndimit



Itali, ndalohej 53-vjeçari: dyshohet se mbyti në gjumë nënë...



Epidemia e Ebolës ndez tensionet në Kongo, zyrtari i UDP...



Destri Spielberg kurorëzon dashurinë me Jake Herskowitz,...



Mazhoranca rrëzon në Kuvend propozimin e PD-së për ndarjen e...



Fitore historike e kombëtares sonë", Fredi Beleri reagon p...



Kosova U21 përgatitet për Qipron me synimin për të marrë një tjetër...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Ai permena gjithashtu aktakuzën dhe procesin gjyqësor ndaj Slobodan Millosheviqit, si dhe vendimet përfundimtare kundër zyrtarëve të lartë politikë, ushtarakë dhe policorë serbë. Për akuzat e Vuçiqit ndaj Kroacisë, të cilën e ka fajësuar për "ringritjen e nazizmit" dhe për "krenarinë me të kaluarën naziste", pretendime që sollën reagimin e menjëhershëm të kryeministrit Andrej Plenković, Fetoshi thotë se ato synojnë të ndërtojnë një viktimizim serb përmes përzgjedhjes së njëanshme të ngjarjeve të Luftës së Dytë Botërore.

Një kapitull të veçantë në analizë i kushtohet marrëdhënies së Vuçiqit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Fetoshi vlerëson se presidenti serb u përpoq ta ndajë politikën amerikane në dy pjesë: Presidentin Clinton e etiketon si "rrënues" të rendit ndërkombëtar, ndërsa Presidentin Trump e paraqet me tone lavdëruese dhe si një "shpresë" për korrigjimin e këtij rendi.

Po ashtu, Fetoshi e kundërshton pretendimin e Beogradit për "neutralitetin" e Serbisë. Sipas tij, rreshtimi strategjik i vendit drejt Rusisë dhe Kinës bie ndesh me këtë deklaratë, ndërkohë që Serbia synon të përfitojë edhe nga procesi i integritetit evropian.

Në këtë kuadër, ai e cilëson Vuçiqin si një "zëdhënës evropian" të Putinit për narrativën e standardeve të dyfishta të Perëndimit. Fetoshi shton se fjalimi i presidentit serb nuk mund të kuptohet plotësisht pa u parë edhe raporti i tij me trashëgiminë politike të Slobodan Millosheviqit.

Ai sjell në vëmendje deklaratat e Vuçiqit për Millosheviqin gjatë vitit 2018, si dhe diskutimet e fundit në Serbi për rehabilitimin politik të ish-presidentit jugosllav. Sipas Fetoshit, shmangia e përgjegjësisë për periudhën e Millosheviqit nuk lidhet vetëm me mënyrën e interpretimit të historisë, por edhe me përshtatjen e projektit nacional serb me rrethanat e shekullit XXI.

Fetoshi e lidh këtë zhvillim me konceptin e "Botës Serbe", të cilin e përshkruan si një version të riformatuar të objektivave të mëparshme nacionaliste. Ndryshe nga e kaluara, ky projekt shfaqet më pak përmes deklarimeve të drejtpërdrejta dhe më shumë përmes narrativave historike, viktimizimit, ndikimit politik dhe marrëdhënieve strategjike.

Në përmbyllje, analiza fokusohet te mënyra se si politika përcillet përmes komunikimit. Duke iu referuar interaksionizmit simbolik të George Herbert Mead, Fetoshi argumenton se faktet nuk marrin vetvetiu një kuptim politik; ai kuptim krijohet përmes mënyrës se si interpretohen dhe vendosen në një kornizë të caktuar. Sipas tij, pikërisht kjo e shpjegon rëndësinë e strategjisë së ndjekur nga Vuçiqi.

Fetoshi vëren se në realitetin digjital të "pas së vërtetës", dokumentet gjyqësore dhe raportet historike mund të mos arrijnë te publiku, ndërsa interpretimet politike të së shkuarës mund të riformatohen për t'iu përshtatur audiencave të reja.

Përballë kësaj, ai përmend raportet e Human Rights Watch dhe Amnesty International për Kosovën, vendimet e ICTY-së, si dhe rastet e varrezave masive në Batajnicë, Petrovo Selo e Rudnicë. Këto, sipas tij, përbëjnë një kundërpeshë dokumentare ndaj narrativës që ndërhyrjen e NATO-s e paraqet si "Mëkat" të Perëndimit. "Komunikimi i vazhdueshëm i fakteve, me kuptimin e provuar nga drejtësia dhe të dokumentuar nga mediat, është formula më e mirë për dekonstruktimin e 'kurthit narrativ' të Vuçiqit", ka shkruar Fetoshi.

Shtuar më 28.09.2026 20:19

Tags: Arben Fetoshi , OKB , vuçiq



Mbetjet mortore të dy personave identifikohen, nuk i përkasin "Grupit të...



Remi rikthen thirrjen për një bashkëqeverisje mes VV-së dhe PDK-së



Afati për zgjedhjen e Presidentit po skadon, Gjanaj: LVV dhe PDK en...



Zgjedhja e Presidentit para afatit të 6 tetorit: A mund të gjejnë marrëveshje LVV-j...



Afati i 6 tetorit për presidentin e ri po mbyllet,



Deliu i kërkon Gërvallës procedimin urgjent të



Protesta "Jo në emrin tim" zhvillohet sonte për të 13-



LDK-ja propozon përfaqësuesit e saj për 16



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.